

Punim Diskutues

KUSH ËSHTË SHEFI?

3 dhjetor 2008

Ky punim diskutues është hartuar me përkrahjen zemërgjërë të KFOS dhe TIRI.

Copyright ©IKS.

~PËRMBAJTJA~

HYRJE	3
PRANVERA E KOSOVËS	3
PAZARI I MADH I BEOGRADIT	5
DYFYTYRËSIA	6
GJASHTË PIKAT FAMËKEQE	7
MËSIMET E MËSUARA NGA UNMIK.....	13
STRATEGJIA DALËSE.....	17
PERSPEKTIVA EVROPIANE	19

HYRJJE

Optimistët në mesin tonë, të cilët kishin besuar që pavarësia do të sjell rregulla të qarta të qeverisjes, llogaridhënies demokratike dhe qartësi për të ardhmen e Kosovës, tash e disa muaj nuk po frymojnë lirshëm. Situata në terren ka krijuar një sistem edhe më të ngatërruar të qeverisjes që ka përjetuar Kosova ndonjëherë. Nëntë muaj pas shpalljes së pavarësisë, Kosova sot qeveriset nga një miriadë e autoriteteve garuese – UNMIK-u, ZCN-ja, EULEX-i, qeveria e Kosovës dhe institucionet paralele serbe. Që nga 17 shkurti, në Kosovë nuk kanë ndodhur shumë ndryshime pozitive.

Kosova de fakto është e ndarë, dhe as Prishtina e as bashkësia ndërkombëtare nuk kanë kontroll efektiv mbi pjesën veriore të vendit. Zyra Civile Ndërkombëtare, e udhëhequr nga Peter Feith, diplomat me përvojë të gjatë në rajonin e Ballkanit, dhe me mandat për ta mbikëqyr zbatimin e Marrëveshjes së Ahtisaarit, i ka duart e lidhura sepse nuk ka shumë ‘zbatim’ për të monitoruar.

UNMIK-u, i cili është ende larg nga dorëzimi i kompetencave të plota tek misioni i BE-së për sundim të ligjit, është në proces të rikonfigurimit – apo më fjalë tjera po e rishkruan përshkrimin e punës së vet për të siguruar një prezencë të vazhdueshme për afat të padefinuar kohor. Akoma pa zbarkuar plotësisht në Kosovë, EULEX-i, misioni i ri i BE-së për sundim të ligjit, nuk gëzon fare popullaritet. Disa mijëra protestues demonstuan në rrugët e Prishtinës duke thirrur ‘poshtë EULEX-i.’ Në fakt, Kosova sot gjendet në situatën më të mjegulluar dhe të paqartë që nga përfundimi i konfliktit në vitin 1999.

Me këtë punim, IKS-i shtron dy pyetje të thjeshta por edhe të vështira: kush është në të vërtetë shefi i Kosovës së pavarur? Dhe për shkak të strukturave të përziera të qeverisjes në Kosovë, kur do t’i përmbush Kosova aspiratat e saj për anëtarësim në BE si shtet funksional dhe i pavarur?

PRANVERA E KOSOVËS

Më 17 shkurt 2008, Kosova shkroi historinë. Në atë ditë të ftohtë të muajit shkurt, rrugët e Prishtinës ishin mbushur me të rinjë që valonin flamuj dhe me turma brohoritëse. CNN-i dhe BBC-ja kishin transmetim të drejtpërdrejtë nga Prishtina pothuajse tërë ditën. Në orën 15, arriti edhe momenti i pritur aq gjatë: Kryeministri i Kosovës e lexonte Deklaratën e Pavarësisë në gjuhën shqipe dhe serbe.

‘Duke nderuar të gjithë meshkujt dhe femrat që kanë bërë sakrifica të mëdha për të ndërtuar një të ardhme më të mirë për Kosovën, Ne, udhëheqësit e popullit tonë, të zgjedhur në mënyrë demokratike, e shpallim Kosovën shtet të pavarur dhe

sovrän. Kjo deklarätë pasqyron vullnetin e popullit tonë dhe është në pajtim të plotë me rekomandimet e të Dërguarit të Posaçëm të OKB-së Martti Ahtisaari dhe Propozimit të tij Gjithëpërfshirës për Marrëveshjen e Statusit të Kosovës.¹

Ëndrra shekullore ishte realizuar; për shumicën e kosovarëve, kjo ishte dita më e lumtur në jetën e tyre. Kishte shpresa të mëdha se Kosova më nuk do të administrohej nga UNMIK-u dhe se do të përmbushej premtimi i bashkësisë ndërkombëtare që Kosova të bëhej një vend ‘normal’ evropian, i pandarë dhe multietnik.

Vendi i parë që e njohu pavarësinë e Kosovës ishte Kosta Rika, e përcjell menjëherë nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Britania e Madhe, Turqia dhe Shqipëria.² Gjatë stinës së pranverës, arrinin lajme për njohje të reja ndërkombëtare, dhe deri sot janë bërë gjithsej 52 shtete që e kanë njohur pavarësinë e Kosovës. Më 15 qershor hyri në fuqi Kushtetuta e re e Kosovës. Ceremonia e nënshkrimit shënoi edhe një hap historik për shtetin e porsalindur. Neni 1 i Kushtetutës definon Republikën e Kosovës si shtet të pavarur, sovran, demokratik, unik dhe të pandarë. Neni 2 thekson që sovraniteti dhe integriteti territorial i Republikës së Kosovës është i paprekshëm, i patjetërsueshëm, i pandashëm dhe i mbrojtur me të gjitha masat e përcaktuara me këtë Kushtetutë dhe me ligj.

Periudha nga muaji shkurt deri në verë të vitit 2008 me gjasë do të mbahet në mend si ‘pranvera e Kosovës.’ Dita ditës, shteti i ri filloi të vepronte si vend ‘normal’ evropian. Ishin vendosur pikat kufitare dhe shenjat ‘Mirë se vini në Republikën e Kosovës.’ Ministria e re për Punë të Jashtme hapi dhjetë misione diplomatike dhe emëroi ambasadorët e parë të Kosovës. Kosova gjithashtu ka aplikuar për anëtarësim në Fondin Monetar Ndërkombëtar dhe në Grupin e Bankës Botërore. Agjencia Kosovare e Privatizimit morri përgjegjësitë nga Agjencioni Kosovar i Mirëbesimit i cili ishte udhëhequr nga ndërkombëtarët. Autoriteti Bankar Qëndror është riemruar Banka Qëndrore e Republikës së Kosovës. Në pajtim me Marrëveshjen e Ahtisaarit, u miratuan ligjet me anë të të cilave autoritetet kosovare merrnin përsipër përgjegjësitë për forcën policore, për sigurinë dhe agjensionin e inteligjencës. Në muajin korrik, Ministria e Punëve të Brendshme lëshoi pasaportat e para kosovare.

15 qershori duhej të ishte dita e fundit e protektoratit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara në Kosovë; për herë të parë pas nëntë vitesh, autoritetet kosovare të zgjedhura në mënyrë demokratike duhej të merrnin përgjegjësi të plotë mbi çështjet shtetërore. Por kjo akoma nuk ka ndodhur. Situata rreth qeverisjes në Kosovë kurrë nuk ka qenë më konfuze se sot dhe e ardhmja evropiane e Kosovës është vënë në pikëpyetje.

¹ Deklarata e Pavarësisë së Kosovës, Republika e Kosovës, 17 shkurt 2008

² www.kosovathanksyou.com

PAZARI I MADH I BEOGRADIT

Shpallja e pavarësisë së Kosovës shkaktoi valë dridhjeje në klasën politike në Serbi. Ditën kur u shpall pavarësia e Kosovës, një bombë dore shpërtheu afër gjykatës së OKB-së në Mitrovicën Veriore. Një bombë tjetër e dorës dështoi të shpërthente jashtë ndërtesës së misionit të ardhshëm të BE-së. Mesazhi politik ishte i qartë: ekstremistët serbë kishin vënë në shënjestër institucionet multietnike dhe të gjitha simbolet e shtetit të ri të Kosovës – përfshirë gjykatat, policinë, doganat dhe vendkalimet kufitare.

Ditën tjetër në Beograd, protesta paqësore “Kosova është Serbi” me rreth 250,000 pjesëmarrës shpërtheu në dhunë me ç’rast një person mbeti i vdekur dhe rreth 150 të tjerë u plagosën (35 prej tyre ishin policë). Në shënjestër të protestuesve ishin ambasadat e vendeve që kishin çelur shtegun drejt njohjes së pavarësisë së Kosovës. Ambada e Turqisë u sulmua e para me gurë, pastaj u sulmuan edhe ambasadat e Kroacisë dhe të SHBA-ve. Protestuesit hipën në ballkonin e ambasadës amerikane, e ulën flamurin, i vunë zjarrin dhe e zëvendësuan atë me flamurin serb; pas pak, e tërë ambada u vu në zjarr. Por dhuna nuk kishte shpërthyer vetëm në Beograd.

Si territori i fundit i kontestuar në Kosovë, pjesa veriore e vendit poashtu shpërtheu në dhunë. Më 19 shkurt, një turmë prej qindra serbëve të Kosovës shkatërruan dhe dogjën dy vendkalimet kufitare – Portën 1 dhe Portën 31 – në kufirin në mes Kosovës dhe Serbisë.³ Paqeruajtësit e Kombeve të Bashkuara u desh të shpëtojnë policët kosovarë që kishin menaxhuar kufirin. Nën presion nga radikalët dhe të joshur nga premtimet financiare të Beogradit, policët serbë të Shërbimit Policor të Kosovës dorëzuan distinkтивët e tyre dhe u kthyen në shtëpi. Kisha Ortodokse Serbe në Kosovë iu bashkua bojkotit; më 3 mars, Peshkopi Artemije urdhëroi klerikët e tij t’i ndërpresin të gjitha kontaktet me autoritetet kosovare.⁴ Beogradi poashtu bëri përpjekje për të vënë nën kontroll vijën hekurudhore që lidhte Lesakun me Zveçanin.⁵ Dhuna arriti pikën më të lartë më 17 mars.

Disa ditë më herët, një turmë prej rreth 40 personash, përfshirë këtu edhe pjesëtarë të Ministrisë për Punë të Brendshme të Serbisë, kishin hyrë me dhunë dhe kishin zaptuar ndërtesën e Gjykatës në pjesën veriore të Mitrovicës. Në orët e hershme të 17 marsit, Policia e UNMIK-ut e përkrahur nga KFOR-i u përpoq ta merrte kontrollin mbi ndërtesën e gjykatës. Policia e UNMIK-ut dhe KFOR-i u ndeshën me armë zjarri nga serbët dhe u sulmuan me gurë, koktejë Molotov dhe me granata dore. 22 ushtarë të KFOR-it, 42 policë ndërkombëtarë dhe kosovarë, mbeten të plagosur. Dhuna arriti kulmin e saj me vdekjen tragjike të policit 26-vjeçar nga Ukraina Kynol Igor.⁶

³ Agence France-Presse; ‘Serbs Attack Kosovo border points as tensions mount,’ Ismet Hajdari; 19 shkurt 2008

⁴ Associated Press; ‘Serb Rail Company retakes control of rail line in northern Kosovo,’ Zvezdan Djukanovic; 3 mars 2008

⁵ Agence France-Presse; ‘UN Reasserts Control Over Railway Line in north Kosovo’; 5 mars 2008

⁶ Konferenca për Shtyp e UNMIK-ut – Konferenca e veçantë e ZPSSP Larry Rossin, COMKFOR Lt.-Gjen. Xavier Bout de Marnack dhe Komisioneri i Policisë Larry Wilson; 18 mars 2008

Këto nuk ishin sulme të izoluara apo spontane të një turmë të mllefosur; Ministri i atëhershëm i Serbisë për Kosovë, Slobodan Samargjiq, në mënyrë publike përkrahu dhunën duke thënë se ‘veprimi i sotëm është në përputhje me politikat e përgjithshme qeveritare.’ Sipas tij, djegia e pikave kufitare dhe doganore më 19 shkurt ishin ‘veprime legjitime.’⁷ Kryeministri i atëhershëm serb Kostunica poashtu premtoi që Serbia nuk do të ndalej derisa ‘të mos anulohet shpallja ilegale e shtetit të rremë të Kosovës’ dhe shtoi që ‘Serbia do të udhëhiqte hap pas hapi dhe se në fund do të triumfonte.’

Për dallim nga trazirat e 17 marsit 2004, këtë herë reagimi i bashkësisë ndërkombëtare në Kosovë ishte i butë. Deri sot, duket se askush nuk është sjell para drejtësisë.

DYFYTYRËSIA

Shpallja e pavarësisë së Kosovës më 17 shkurt 2008 nuk erdhi si befasi. Përkundrazi, shpallja e pavarësisë ishte rezultat i disa viteve të diplomacisë ndërkombëtare dhe negociatave të nivelit të lartë. Madje edhe data dhe teksti i deklaratës së pavarësisë ishin vendosur dhe hartuar në pajtim me zyrat ndërkombëtare në Prishtinë.

Në fillim të vitit 2006, Martti Ahtisaari u emërua i Dërguari i Posaçëm i Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara për të nisur procesin e negociatave në mes Prishtinës dhe Beogradit. Muaj të tërë të negociatave dhe diplomacisë fluturuese rezultuan në një dokument të kalibruar me kujdes dhe të quajtur Propozimi Gjithëpërfshirës për Marrëveshjen mbi Statusin e Kosovës, i njohur edhe si ‘Marrëveshja e Ahtisaarit.’ Në shkurt të vitit 2007, Ahtisaari i rekomandoi me fjalë të qarta Këshillit të Sigurimit të OKB-së t’ia jepte pavarësinë Kosovës. Ai argumentonte që:

‘Pavarësia është opsioni i vetëm për një Kosovë politikisht stabile dhe ekonomikisht të qëndrueshme.’⁸

Në letrën e tij dërguar Këshillit të Sigurimit më 26 mars 2007, Ban Ki-moon në mënyrë të hapur përkrah rekomandimin e Ahtisaarit për t’i dhënë Kosovës pavarësinë. Letra e nënshkruar nga Ban Ki-moon në mënyrë të qartë thotë:

‘Duke i marrë parasysh zhvillimet në procesin për përcaktimin e statusit të ardhshëm të Kosovës, unë plotësisht përkrah rekomandimet e të Dërguarit tim të Posaçëm në raportin e tij për statusin e ardhshëm të Kosovës si dhe Propozimin Gjithëpërfshirës për Marrëveshjen mbi Statusin e Kosovës.’

⁷ BBC News; ‘Serb ministers plan Kosovo visit’; 25 shkurt 2008

⁸ Letra e datës 26 mars 2007 nga Sekretari i Përgjithshëm për Presidentin e Këshillit të Sigurimit, f.5, pika 10

Një vit e gjysmë më vonë, e tërë kjo duket histori e largët. Me përkrahjen diplomatike të Rusisë e cila gëzon të drejtën e vetos, Beogradi ka korrur disa fitore të rëndësishme diplomatike. Premtimi i Tadiqit për zhbërjen e pavarësisë së Kosovës me anë të masave ligjore dhe politike është shndërruar në strategji të dyfishtë. Në njerën anë, Beogradi kërkon me ngulm mendimin ndërkombëtar të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë (GJND). Më 8 tetor 2008, Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së, përkrahi kërkesën e Serbisë; 77 prej 192 vendeve anëtare votuan në favor të kërimit të mendimit joobligativ të GJND-së për ligjshmërinë e shpalljes së pavarësisë së Kosovës.⁹

Megjithatë, ç'është më e rëndësishme, Beogradi kërkon me ngulm t'i detyroj të gjitha palët të kthehen në tavolinën e bisedimeve. "Ne jemi të gatshëm të kthehemi në tavolinën e bisedimeve dhe ne do të këmbëngulim për këtë në të gjitha forumet ndërkombëtare. Kjo do të jetë strategjia dhe përgjigja jonë ndaj shpalljes së të ashtuquajturit shtet ilegal të Kosovës dhe Metohisë," deklaroi Tadiq më 15 qershor 2008.¹⁰ Në fakt, që në muajin prill të vitit 2008, OKB-ja po zhvillonte bisedime me Serbinë. Atëbotë, megjithatë, besohej që 'ka shumë pak gjasa që bisedimet të jenë të frytshme.'¹¹

I dobësuar nga mungesa e mandatit të qartë ligjor nga Këshilli i Sigurimit i OKB-së, në përpjekje për ta zbarkuar tërë kapacitetin dhe duke u përballur me rezistencë të ashpër nga komuniteti serb i Kosovës, misioni i BE-së për sundim të ligjit (EULEX) ishte më se i gatshëm t'i rinegocionte kushtet e zbarkimit të tij në Kosovë. Presidenti serb Boris Tadiq vazhdimisht deklaronte që misioni i EULEX-it ishte i mirëseardhur në Kosovë vetëm nën dy kushte: që të paraprihej nga një vendim i Këshillit të Sigurimit të OKB-së dhe që të mos e zbatonte Planin e Ahtisaarit, që përfshin edhe pavarësinë e mbikëqyrur të Kosovës.

GJASHTË PIKAT FAMËKEQE

Më 12 qershor, kontratat e marrëveshjes së re në mes Beogradit dhe Nju Jorkut filluan të marrin formë. Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së Ban Ki-moon iu dërgoi dy letra të ndara Presidentit Sejdiu dhe Presidentit Tadiq, duke premtuar 'rikonfigurimin e strukturës dhe natyrës së prezencës civile ndërkombëtare' si përgjigje ndaj 'gjendjes thelbësisht të ndryshuar në Kosovë.' Rikonfigurimi i UNMIK-ut do t'i 'mundësonte Bashkimit Evropian të marrë rol të shtuar operacional në Kosovë.' Fjala kyçe, megjithatë, ishte që roli i ri i BE-së do të ishte 'në pajtim me Rezolutën 1244.'¹² Kjo përfaqësonte ndryshim dramatik nga politika e mëhershme e Ban Ki-moon në përkrahje të pavarësisë së Kosovës dhe në të njëjtën kohë ndryshim dramatik të planit origjinal për zbarkimin e EULEX-it.

⁹ Bill Varner, 'UN Members ask for Legal Ruling on Kosovo's Status,' Bloomberg; 8 tetor 2008.

¹⁰ B92 NEWS; 15 qershor 2008

¹¹ Dusan Janjiq, Drejtor i Forumit për Marrëdhënie Etnike, 23 prill 2008

¹² Raporti i Sekretarit të Përgjithshëm për Misionin e Përkohshëm të Administratës së Kombeve të Bashkuara në Kosovë (S/2008/354), kapitulli III, paragrafi 13; 12 qershor 2008

Më 26 qershor, UNMIK-u zyrtarisht shpalli fillimin e procesit të rikonfigurimit. Si pjesë e këtij procesi, Shtylla e Katërt e UNMIK-ut u mbyll dhe Agjencioni Kosovar i Privatizimit morri kompetencat nga Agjencioni Kosovar i Mirëbesimit. Departamenti i UNMIK-ut për Administratë Civile dhe Zyra për Komunitete, Kthim dhe Pakica pushuan së ekzistuari.¹³ Zyrat e UNMIK-ut në terren u reduktuan në masë drastike, përderisa misioni mbajti prezencë të fortë në pjesën veriore të Mitrovicës dhe në veri të Kosovës. Ban Ki-moon bëri me dije që Qeveria e Kosovës kishte dhënë indikacione që do ta mirëpriste prezencën e OKB-së në Kosovë ‘me kusht që ajo të kryente detyra të kufizuara.’¹⁴

Në raportin e tij të fundit më 24 nëntor, Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së përmendi ‘realitetet dhe sfidat e reja’ për autoritetin e UNMIK-ut në terren dhe i raportoi Këshillit të Sigurimit që si ‘pasoje e rrugëve thelbësisht të ndryshme të Beogradit dhe autoriteteve kosovare pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës, hapësira në të cilën mund të operoj UNMIK-u ka ndryshuar.’ Ai theksoi që ‘Përfaqësuesi Special po ballafaqohet me vështirësi të shtuara gjatë ushtrimit të mandatit të tij si pasojë e konfliktit në mes Rezolutës 1244 (1999) dhe Kushtetutës së Kosovës’, të cilën ‘UNMIK-u nuk e merr parasysht.’

Në këtë raport, Ban Ki-moon tha që shpresonte se EULEX-i së shpejti do të:

‘Marr përsipër përgjegjësitë në fushat e policisë, drejtësisë dhe doganave, nën autoritetin e përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara, nën ombrellën e Kombeve të Bashkuara të udhëhequr nga Përfaqësuesi im Special, dhe në pajtim me rezolutën 1244.’¹⁵

Gjatë një interviste në muajin mars të këtij viti, Yves de Kermabon premtoi që roli i EULEX-it do të dallonte nga ai i UNMIK-ut. Deri në verë, Kermabon vazhdimisht theksonte që EULEX-i nuk do të ishte nën Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së dhe që EULEX-i nuk do të merrte urdhra nga Selia e OKB-së në Nju Jork. Përkundrazi, që nga zanafilla e tij EULEX-i ishte dizajnuar të jetë projekti kryesor i Politikës Evropiane të Sigurisë dhe Mbrotjtjes.

Fillimisht, EULEX-i duhej t’i ndihmonte institucionet kosovare ta ndërtojnë drejtësinë, policinë dhe shërbimin doganor të pavarur, multietnik dhe sipas praktikave më të mira

¹³Raporti i Sekretarit të Përgjithshëm për Misionin e Përkohshëm të Administratës së Kombeve të Bashkuara në Kosovë (S/2008/692), kapitulli X, paragrafi 22; 24 nëntor 2008

¹⁴ Raporti i Sekretarit të Përgjithshëm për Misionin e Përkohshëm të Administratës së Kombeve të Bashkuara në Kosovë (S/2008/354); 12 qershor 2008

¹⁵ Raporti i Sekretarit të Përgjithshëm për Misionin e Përkohshëm të Administratës së Kombeve të Bashkuara në Kosovë (S/2008/692), kapitulli X, paragrafi 23; 24 nëntor 2008

evropiane.¹⁶ Si pjesë të EULEX-it, vendet anëtare të BE-së u zotuan të dërgojnë afro 2,200 kuadro ndërkombëtare – përfshirë mbikëqyrës policor, njësi policore të specializuara kundër trazirave, prokurorë dhe ekspertë gjyqësor – në kosto mujore prej më tepër se 13 milion euro (pa i përfshirë këtu kostot e konsiderueshme për kuadrot e deleguara).¹⁷ Në shumë aspekte, kredibiliteti i BE-së që ta luaj rolin e aktorit global dhe t'i përfaqësoj interesat e saj në arenën ndërkombëtare varet nga suksesi i EULEX-it.

Vlen të përkujtohet që EULEX-i është pjesë integrale e Marrëveshjes së Ahtisaarit. Neni 13.3 i kësaj Marrëveshje thotë:

‘Misioni i ESDP-së do ta përkrah zbatimin e kësaj Marrëveshjeje dhe do të ofroj mentorim, monitorim dhe këshillim në fushën e sundimit të ligjit, duke mbajtur disa kompetenca të caktuara posaçërisht në fushën e drejtësisë, policisë, doganave dhe shërbimeve korrektuese.’

Aneksi IX 2.3 cakton kompetencat dhe privilegjet e misionit të ESDP-së, përfshirë autoritetin e këtij misioni që të hetoj krimet e luftës, krimin e organizuar dhe korrupsionin, autoritetin që të ftoj prokurorë ndërkombëtarë të merren me raste të ndjeshme dhe përgjegjësinë për monitorimin dhe këshillimin e agjencioneve vendore për zbatimin e ligjit në të gjitha fushat që ndërlidhen me sundimin e ligjit. Neni 2.3 i Aneksit IX poashtu cek në mënyrë të qartë që prokurorët ndërkombëtarë që janë pjesë e EULEX-it si dhe gjykatësit ndërkombëtarë do të shërbejnë edhe në sistemin gjyqësor të Kosovës dhe në pajtim me ligjet kosovare. Në fund por jo më pak e rëndësishme, Misioni i ESDP-së poashtu gëzon:

‘Autoritetin për të siguruar zbatimin efikas të kësaj Marrëveshjeje nëpërmjet përmbushjes së detyrave që i janë deleguar Misionit të ESDP-së’ (Aneksi IX, 2.3.h)

Si rezultat i presionit diplomatik nga Beogradi dhe marrëveshjes së arritur prapa dyerve të mbyllura, këto dispozita, që janë përkrahur nga autoritetet kosovare dhe të gjitha 52 vendet që e kanë njohur pavarësinë e Kosovës në bazë të Marrëveshjes së Ahtisaarit, nuk qëndrojnë më. I etur që të zbarkoj, EULEX-i është pajtuar me kushtet e reja të propozuara nga Serbia dhe të pajtuara në mes Beogradit, Nju Jorkut dhe Brukselit.

‘Marrëveshja e re’ e cila në rrugët e Prishtinës njihet si ‘plani gjashtëpikësh i Ban Ki-moon’ mbulon përgjegjësitë kyçe shtetërore përfshirë këtu policinë, doganat, drejtësinë, transportin dhe infrastrukturën, kufijtë dhe trashëgiminë serbe. Të gjitha këto fusha janë

¹⁶ Komunikatë për Shtyp nga Këshilli i Bashkimit Evropian me titull ‘Kosova: Këshilli themelon Misionin e BE-së për Sundim të Ligjit, emëron Përfaqësuesin Special të BE-së,’ Bruksel, 16 shkurt 2008

¹⁷ Buxheti total zyrtar për 16 muajt e parë është 208 milion Euro.

diskutuar në mënyrë thelbësore gjatë procesit të negociatave të udhëhequr nga vet i Dërguari i Posaçëm i OKB-së, Martti Ahtisaari.

Çështjet që kanë të bëjnë me policinë dhe kufijtë janë trajtuar në mënyrë përmbajtësore në Nenin 9 dhe në Aneksin VIII të Marrëveshjes së Ahtisaarit. Neni 2 i Aneksit VIII konfirmon që Kosova do të ketë një zinxhir unik komandues për shërbimet policore në mbarë vendin. Marrëveshja e Ahtisaarit poashtu përmban dispozita për të siguruar që përbërja etnike e forcës policore në një komunë të caktuar është në pajtim me përbërjen etnike të kësaj komune. Marrëveshja përmban edhe dispozita të veçanta të cilat i mundësojnë komunave me shumicë serbe t'i zgjedhin komandantët e stacioneve lokale policore.

Aneksi IV në tërësi i kushtohet sistemit gjyqësor në Kosovë, përfshirë edhe dispozitat për përfaqësimin e pakicave në radhët e gjykatësve, prokurorëve dhe në Këshillin Gjyqësor të Kosovës si dhe dispozitat të cilat mundësojnë themelimin e gjykatave të reja komunale.

Aneksi V përmban garanci të veçanta për mbrojtjen e trashëgimisë serbe në Kosovë. Kisha Ortodokse Serbe gëzon një listë të gjatë të privilegjeve, imuniteteve dhe masave mbrojtëse, përfshirë zonat e mbrojtura dhe themelimin e Këshillit Zbatues dhe Mbikëqyrës për mbikëqyrjen e të gjitha dispozitave që kanë të bëjnë me trashëgiminë fetare dhe kulturore. Marrëveshja e Ahtisaarit jo vetëm që është marrë në mënyrë përmbajtësore me të gjitha gjashtë pikat, por ajo poashtu përmban edhe disa lëshime të dhimbshme.

Megjithatë, 'plani gjashtëpikësh' i ri, shkon përtej koncesioneve me të cilat Prishtina ishte pajtuar fillimisht si pjesë e marrëveshjes së përgjithshme. Në fakt, 'plani gjashtëpikësh' i ri i ngjason në mënyrë irrituese kërkesave të cilat Beogradi i kishte shtruar gjatë procesit të negociatave. Nuk mund t'i shmangesh përshtypjes që ato të cilat Beogradi dështoi t'i arrij gjatë procesit të negociatave me Prishtinën nën udhëheqjen e OKB-së, tash po mundohet t'i fut si pjesë e marrëveshjes për zbarkimin e EULEX-it.

Plani i Ban Ki-moon parasheh që stacionet dhe nën-stacionet në zonat e pakicave do të mbesin nën zinxhirin **aktual** komandues, nën mbikëqyrje të policisë ndërkombëtare. Plani poashtu parasheh që Komisioneri i Policisë së **UNMIK-ut** të emëroj një zyrtar të lartë serb të policisë i cili do t'i raportoj policëve ndërkombëtarë. Sa i përket doganave, plani i Ban Ki-moon parasheh rivendosjen e zyrtarëve **ndërkombëtarë** të doganave në Portat 1 dhe 31, të cilët do të aplikojnë procedura në pajtim me Rezolutën 1244 dhe tarifa në përputhje me Rregulloren 2004/1 të **UNMIK-ut**. Plani parasheh që Kosova do të vazhdoj të funksionoj si një zonë e vetme doganore dhe shton: 'Këto diskutime poashtu

do të adresojnë ndërprerjen e të hyrave doganore që mblidhen në Portat 1 dhe 31, të cilat sipas nevojës duhet të shkojnë në përfitim të komuniteteve lokale.¹⁸

Sipas këtij plani, gjykata në Mitrovicë është hapur përsëri, dhe ajo zbaton **vetëm ligjet e UNMIK-ut** dhe ka vetëm **kuadro të UNMIK-ut**. Në të ardhmen, gjykatësit dhe prokurorët në zonat relevante me shumicë serbe do të vazhdojnë të emërohen në pajtim me Rezolutën 1244, dhe jo në pajtim me sistemin gjyqësor të Kosovës dhe me ligjet e Kosovës.

Përkundër dispozitave të gjëra në Marrëveshjen e Ahtisaarit, plani gjashtëpikësh poashtu thërret për **dialog të vazhdueshëm** në mes Beogradit dhe Prishtinës për trashëgiminë serbe dhe për mbrojtjen e vazhdueshme ndërkombëtare të Kishës Ortodokse Serbe.

Ç'është më e rëndësishme, siç tha Ban Ki-moon në letrën e tij të dërguar më 12 qershor, plani gjashtëpikësh është i hartuar në mënyrë specifike për 'zonat e banuara me shumicë serbe'.¹⁹ Me fjalë tjera, për veriun e trazuar të Kosovës, dokumenti synon të siguroj që 'gjendja politike dhe ajo e sigurisë në Kosovë dhe në rajon të mbetet e qetë' dhe të mbrohen komunitetet pakicë. Kjo në masë të madhe tingëllon si 'një operacion tjetër për vazhdimin e status kuos' i propozuar nga institucioni i njejtë që nuk ia doli ta përmirësonte gjendjen në pjesën veriore të Kosovës për nëntë vite me radhë. Posaçërisht gjatë nëntë muajve të fundit pas 17 shkurtit, UNMIK-u ka humbur kontrollin mbi Veriun pas dhunës së dirigjuar nga ekstremistët serbë. Administrata e UNMIK-ut ju ka lejuar mu para hundës së saj grupeve kriminele të krijojnë vakum ligjor dhe parajsë të kontrabandës. Atëherë shtrohet pyetja: pse duhet të ndryshoj vendosmëria e UNMIK-ut – apo aftësia e EULEX-it – për ta rikthyer kontrollin mbi Veriun, me planin gjashtëpikësh? Çfarë garancish ka për të siguruar që këto 'aranzhime të përkohshme' nuk do ta forcojnë më tej krijimin e një shteti nën kontroll të UNMIK-ut dhe me polici të EULEX-it përbrenda shtetit të pavarur të Kosovës?

Edhe pse UNMIK-u dhe EULEX-i vazhdimisht potencojnë që këto aranzhime janë vetëm të përkohshme, plani gjashtëpikësh mbetet me afat të padefinuar kohor. Dispozitat e vetme që përmendin aspektin kohor thonë që 'çdo aranzhim për gjashtë pikat do të vlej deri në themelimin e mekanizmave relevante përcjellëse'.²⁰ Ky formulim i jep hapësirë të mjaftueshme UNMIK-ut të vazhdoj 'procesin e rikonfigurimit' për afat të padefinuar kohor.

Gjatë muajve të fundit, autoritetet në Prishtinë kanë shprehur rezerva për mungesën e kornizës së qartë kohore për procesin e rikonfigurimit dhe për kompetencat që do të

¹⁸ Raporti i Sekretarit të Përgjithshëm për Misionin e Përkohshëm të Administratës së Kombeve të Bashkuara në Kosovë (S/2008/692), kapitulli XI, paragrafi 38; 24 nëntor 2008

¹⁹ Letra e datës 12 qershor 2008 nga Sekretari i Përgjithshëm te Presidenti Boris Tadiq, pika 2

²⁰ Raporti i Sekretarit të Përgjithshëm për Misionin e Përkohshëm të Administratës së Kombeve të Bashkuara në Kosovë (S/2008/692), kapitulli XI, paragrafi 28; 24 nëntor 2008

mbesin në duart e UNMIK-ut.²¹ Ban Ki-moon e përmend këtë fakt në raportin e tij të fundit.

‘Ata kanë thënë në mënyrë të qartë që nuk i pranojnë rezultatet e aranzhimeve të përfshira në raportin aktual.’

Prishtina zyrtare e rikonfirmoi kundërshtimin e saj në një deklaratë të lëshuar me 18 nëntor. Prishtina përkrah zbarkimin e shpejtë të EULEX-it në pajtim me Deklaratën e Pavarësisë, Kushtetutën, Marrëveshjen e Ahtisaarit, me Planin e Përbashkët të BE-së të miratuar më 4 shkurt dhe me ftesën kosovare për zbarkimin e EULEX-it. Por, në deklaratë poashtu thuhet:

‘Institucionet e Kosovës e kundërshtojnë në tërësi dokumentin gjashtëpikësh.’

Autoritetet e Prishtinës me të drejtë e kundërshtojnë planin gjashtëpikësh. Si mund të mbetet EULEX-i neutral ndaj statusit dhe në të njëjtën kohë ta zbatoj mandatin e tij për ta përkrahur zbatimin e Marrëveshjes së Ahtisaarit? Si mund EULEX-i të ofroj ‘mentorim, monitorim dhe këshillim në fushën e sundimit të ligjit’ kur nuk i njeh ligjet dhe autoritetet kosovare si burimet e vetme të fuqisë legjislative? Si mund EULEX-i ta luftoj në mënyrë efikase krimin e organizuar kur nuk arrin të zbarkoj në mbarë Kosovën? Dhe si mundet një mision i BE-së për sundim të ligjit, i përbërë nga 32 vende përfshirë këtu edhe pesë vende anëtare të BE-së që nuk e njohin pavarësinë e Kosovës, ta fitoj besimin e popullsisë të cilës ai duhet t’i shërbej?

Më 19 nëntor dhe përsëri më 2 dhjetor, koalicioni i organizatave të shoqërisë civile nën udhëheqjen e Vetëvendosjes, ÇOHU dhe Rrjetit të Grave thirrën protestë paqësore në Prishtinë. Gazetat ditore në Prishtinë raportuan që 30,000 qytetarë dolën në rrugë për t’iu bashkuar protestës. Kjo ishte protesta më e madhe që Prishtina kishte parë që nga përfundimi i luftës në vitin 1999. Në mesin e thirrjeve të protestuesve ishin ‘Poshtë EULEX-i,’ ‘Poshtë UNMIK-u,’ ‘UÇK,’ ‘Jo Ndarje’ dhe ‘Duam të jemi sovran.’

Por as protestat në rrugë e as përfshirja në lojën fajësuese të udhëhequr nga opozita nuk janë përgjigje adekuate për gjendjen aktuale. Në mënyrë që ta rikthej pozicionin e saj, Prishtina zyrtare duhet të punoj në partneritet me miqtë e saj në vendet e jashtme dhe të veproj si shtet. Hapi i parë në këtë drejtim është ndërmarrja e qasjes proaktive për përmbushjen e dispozitave të Marrëveshjes së Ahtisaarit që janë në kompetencë të qeverisë kosovare. Ky hap duhet të shoqërohet me një përpjekje të bashkërenduar të diplomacisë publike dhe me një fushatë ndërkombëtare për përmirësimin e imazhit të jashtëm të Kosovës. Nuk mjafton vetëm të flitet dhe stërflitet për planin e Ban Ki-moon dhe për taktikat e Beogradit.

²¹ Raporti i Sekretarit të Përgjithshëm për Misionin e Përkohshëm të Administratës së Kombeve të Bashkuara në Kosovë (S/2008/692), kapitulli XII, paragrafi 52; 24 nëntor 2008

Në njërën anë IKS-i pajtohet që plani gjashtëpikësh paraqet shkelje të kushteve të pranuar si pjesë e Marrëveshjes së Ahtisaarit, por poashtu protestat në rrugë janë këndvështrim afatshkurtër. Nëse sundimi nëntëvjeçar i UNMIK-ut na mëson diçka, kjo është që misionet ndërkombëtare duhet të kenë strategji të qartë të largimit dhe mekanizma për të siguruar të llogaridhënies demokratike. Shikuar nga një këndvështrim afatgjatë, IKS-i nuk brengoset vetëm me planin gjashtëpikësh të Ban Ki-moon. Ne njëlloj brengosemi edhe për faktin që Marrëveshja e Ahtisaarit parasheh fuqi të pakontrolluara ekzekutive për Përfaqësuesin Civil Ndërkombëtar dhe për shefin e EULEX-it.

MËSIMET E MËSUARA NGA UNMIK

Në shumë aspekte, mandati i Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së ishte inovativ. UNMIK-u do të ishte jo vetëm misioni më i madh paqeruajtës në histori të OKB-së, por edhe do të duhej ta 'ndërtonte' një 'shtet' të ri dhe ta qeveris Kosovën në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe për një afat të pacaktuar kohor. Për afro një dekadë, UNMIK-u ishte pushteti më i lartë në Kosovë, kishte funksione dhe kryente detyra që në kushte normale i takojnë një *qeverie*, si në nivelin qendror ashtu edhe në atë lokal. Pa marrë parasysh kompetencat e transferuara nga UNMIK-u, institucionet e Kosovës – nga policia e deri te kontrolli i kufijve – gjithmonë mbetën nën autoritetin e plotë dhe final të PSSP-së.²² Me gjasë, ilustrimi më i mirë për këtë balanc të pushtetit është fakti që ligjet e miratuara nga Kuvendi i Kosovës duhet të 'aprovoreshin' nga PSSP-ja për të hyrë në fuqi.

Që nga dita e parë, zyrtarët e lartë të Zyrës Civile Ndërkombëtare të udhëhequr nga BE-ja bënë përpjekje për të theksuar që misioni i ardhshëm në Kosovë nuk do të ishte i ngjashëm me UNMIK-un. Në dhjetor të vitit 2006, Torbjorn Sohlstrom, kryesuesi i ekipit planifikues të ZCN-së, deklaroi:

'Angazhimi i bashkësisë ndërkombëtare [në Kosovë] do të dalloj shumë nga angazhimi i sotëm, si dhe nga angazhimi të cilin e kemi pasur gjatë shtatë viteve të fundit. [...] Bashkësia ndërkombëtare më nuk do të synoj ta *qeveris* Kosovën [... dhe] përgjegjësia për administrimin e çështjeve të Kosovës do të jetë në duart e përfaqësuesve të zgjedhur [...]. Roli i bashkësisë ndërkombëtare do të jetë: të *ndihmoj* në shumë mënyra [...]; [...] të *monitoroj* [...] zbatimin adekuat të

²² Kjo është thënë edhe në Kornizën Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme, (Rregullorja e UNMIK-ut 2001/9), Kapitulli 12, mbi Autoritetin e PSSP-së, e cila thotë 'Ushtrimi i përgjegjësisë të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes sipas kësaj Kornize Kushtetuese nuk do të ndikojnë apo zbehin autoritetin e PSSP-së për të siguruar zbatimin e plotë të UNSCR 1244(1999), përfshirë këtu mbikëqyrjen e Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes, zyrtarët dhe agjencionet e tyre, dhe ndërmarrjen e masave adekuate sa herë që veprimet e tyre nuk janë në përputhje me UNSCR 1244(1999) apo me këtë Kornizë Kushtetuese.'

marrëveshjes së statusit [...]; dhe të *kushtëz*oj, nëpërmjet procesit të integrimit në [...] BE. [...]²³

Si ilustrim, Sohlstrom përdori një *metaforë* nga sporti i futbollit dhe konkludoi, ‘nëse Kosova është skuadra, bashkësia ndërkombëtare deri më tani ka qenë pronar i skuadrës. Në të ardhmen, shpresojmë të lëvizim drejt rolit të trajnerit.’ Gjatë një takimi me përfaqësues të shoqërisë civile, Peter Feith, në kapacitetin e tij si Përfaqësues Special i BE-së dhe shef i Zyrës Civile Ndërkombëtare, përsëri theksoi që:

‘Filozofia jonë është që Qeveria e Kosovës e ka rolin udhëheqës; ne nuk jemi këtu për ta luajtur rolin udhëheqës, ne jemi këtu për të përkrahur dhe këshilluar.’²⁴

Kjo qasje pasqyron qëllimet origjinale të hartuesve të Propozimit të Ahtisaarit. Kur Ahtisaari i rekomandoi Këshillit të Sigurimit që t’ia jepte pavarësinë Kosovës, ai argumentoi që:

‘Vetëm në Kosovën e pavarur, institucionet e saj demokratike do të jenë plotësisht përgjegjëse dhe të përgjegjshme për veprimet e tyre.’²⁵

Ahtisaari në mënyrë specifike kërkoi që kompetencat e prezencës civile dhe ushtarake ndërkombëtare të jenë ‘të forta – por të përqendruara – në fusha kritike siç janë të drejtat e komuniteteve, decentralizimi, mbrojtja e Kishës Ortodokse Serbe dhe sundimi i ligjit.’²⁶

Hartuesit mund të kenë pasur dëshirë të mirëfilltë që mos ta zëvendësojnë UNMIK-un me ‘EUMIK,’ por në botën e dobive vazhdimisht të ndryshueshme politike ajo që çon peshe në fund nuk janë qëllimet por dokumentet e shtypura në bardh e zi. Një vështrim më i hollësishëm i dokumentit të Ahtisaarit tregon që teksti i jep Përfaqësuesit Civil Ndërkombëtar kompetenca dhe privilegje të gjëra për ta siguruar zbatimin e Marrëveshjes së Statusit.

Këto kompetenca nuk kufizohen vetëm në sigurimin e mbrojtjes së të drejtave të pakicave; me rolin e tij të dyfishtë si Përfaqësues Special i BE-se, Përfaqësuesi Civil Ndërkombëtar gëzon autoritet edhe në fusha tjera të rëndësishme të qeverisjes dhe sundimit të ligjit, përfshirë këtu edhe gjyqësorin, policinë, kontrollin e kufijve, doganat dhe shërbimet korrektuese.²⁷ Përfaqësuesi Civil Ndërkombëtar poashtu gëzon autoritetin

²³ Torbjorn Sohlstrom, Përfaqësues Personal i Javier Solanës dhe shef i EP të ZCN-së, në fjalën e tij në një tryezë të rrumbullakët të organizuar nga Forumi 2015 me titull ‘Statusi pas Statusit,’ të mbajtur më 14 dhjetor held 2006 (citati është marrë nga botimi i muajit shkurt 2007, f.50). Shih edhe intervistën e Torbjorn Sohlstrom me Jeta Xharren, ‘Jeta ne Kosove,’ BIRN/RTK, 9 shkurt 2007.

²⁴ Peter Feith ICR/EUSR, 17 mars 2008. ‘Shoqëria Civile Kosovare në Erën Evropiane,’ takimi i PCN me Shoqërinë Civile, organizuar nga Universiteti i Prishtinës.

²⁵ Letra e datës 26 mars 2007 e Sekretarit të Përgjithshëm për Presidentin e Këshillit të Sigurimit, f.4, pika 10.

²⁶ Letra e datës 26 mars 2007 e Sekretarit të Përgjithshëm për Presidentin e Këshillit të Sigurimit, f.4

²⁷ ‘Propozimi Gjithëpërfshirës për Marrëveshjen mbi Statusin e Kosovës’, aneks në ‘Raport i të Dërguarit të Posaçëm të Sekretarit të Përgjithshëm për Statusin e Ardhshëm të Kosovës’, Këshilli i Sigurimit i OKB-së, S/2007/168/Add.1 Aneks IX, Neni 2.3.

të emëroj në mënyrë të drejtpërdrejt (apo ta jap pëlqimin e tij apo saj për emërimin) zyrtarë në institucione shumë të rëndësishme, siç është Auditori Gjeneral, gjykatësit dhe prokurorët ndërkombëtarë, drejtorët e Shërbimit të Doganave, Administratës Tatimore, Thesarit, të Autoritetit Qendror Bankar të Kosovës, si dhe anëtarët ndërkombëtarë të Bordit të agjencionit për privatizim dhe Agjencionit Kosovar të Pronës.²⁸

Si ‘*autoriteti final në Kosovë*’ për interpretimin e aspekteve civile të Marrëveshjes, Përfaqësuesi Civil Ndërkombëtar do të gëzoj të drejtën të:

‘ndërmarrë *masa korigjuese* për të ndrequr, sipas nevojës, çdo veprim të autoriteteve kosovare që sipas PCN-së paraqesin shkelje të Marrëveshjes, apo që minojnë në mënyrë serioze sundimin e ligjit, apo që në një mënyrë tjetër janë *në mospërputhje me kushtet apo shpirtin* e kësaj Marrëveshjeje.’²⁹

Dokumenti nuk ofron asnjë udhëzim tjetër formal se çka e përbën ‘*shpirtin*’ e Marrëveshjes; kjo është çështje e interpretimit dhe mund të përdoret nga avokatët dinakë. Në listën e ‘*masave korigjuese*’ përfshihet edhe autoriteti për anulimin e ligjeve apo vendimeve të autoriteteve kosovare apo për sanksionimin apo largimin e zyrtarëve publik sipas vendimit të PCN-së.³⁰

Duke i dhënë PCN-së të drejtën eksplicite për largimin e zyrtarëve publik, ‘Marrëveshja e Ahtisaarit’ po hyn në territor të ri: një zyrtar jo i zgjedhur ndërkombëtar merr kompetenca të plota nga Kuvendi i Kosovës për t’i larguar zyrtarët kosovarë derisa këta të fundit nuk do të kenë të drejtë të ankohen për këtë vendim tek një mekanizëm i pavarur.

Në fakt, kur bëhet fjalë për kufizimet e kompetencave, për mekanizmat mbikëqyrës dhe proceset e rishikimit, fjalitë në Marrëveshjen e Ahtisaarit janë të paqarta dhe të turbullta. PCN-ja do të ketë autoritetin – nëse ai apo ajo vendos – të themeloj një mekanizëm për rishikimin e përdorimit të kompetencave të tij apo saj (dhe të kompetencave të PSBE-së), por *pa i paragjykuar privilegjet dhe imunitetet* që i janë dhënë misionit pas statusit.³¹

PCN/PSBE-ja, anëtarët e tij profesional dhe të emëruarit e tij do të gëzojnë të njëjtat privilegje dhe imunitete që i gëzojnë agentët diplomatik sipas Konventës së Vjenës për Marrëdhënie Diplomatike.³² Konventa e Vjenës, megjithatë, nuk është e hartuar t’i jap imunitet zyrtarëve ndërkombëtarë që kanë kompetenca eksplicite për t’u përzier në punët e shtetit. Përkundrazi, Neni 41 thotë:

²⁸ *Ibid.*, Aneks IX, Neni 2.2 dhe Aneksi VII, Neni 2 dhe Neni 4.

²⁹ *Ibid.*, Aneks IX, Neni 2.1.c.

³⁰ *Ibid.*, Aneks IX, Neni 2.1.c dhe Neni 2.1.d.

³¹ *Ibid.*, Aneks IX, Neni 2.6.

³² *Ibid.*, Aneks IX, Neni 4.6.

‘Pa i paragjykuar privilegjet dhe imunitetet e tyre, të gjithë personat që gëzojnë këto privilegje dhe imunitete duhet t’i *respektojnë ligjet dhe rregulloret* e Shtetit ku punojnë. Ata poashtu *nuk duhet të përzihen në punët e brendshme* të atij Shteti.’³³

I vetmi mekanizëm i jashtëm i cili ka kontroll të caktuar mbi kompetencat dhe autoritetin e PCN-së është ‘Grupi Drejtues Ndërkombëtar.’ Si PCN, Peter Feith pritet t’i raportoj rregullisht GDN-së dhe të veproj sipas udhëzimeve të tij.³⁴ Sipas marrëveshjes origjinale të prezantuar në muajin shkurt të vitit 2007, GDN-ja duhej të përbëhej nga përfaqësuesit e Francës, Gjermanisë, Italisë, Rusisë, Britanisë së Madhe, Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Bashkimit Evropian, Komisionit Evropian, dhe NATO-së.³⁵ Si rezultat i kundërshtimit rus ndaj pavarësisë së Kosovës, përbërja e Grupit u desh të ndryshoj. Sot GDN-ja është grup i çlirët i shteteve që e kanë njohur pavarësinë e Kosovës dhe që kanë hise në zhvillimin e saj. Prandaj, Qeveria e Kosovës pritet t’i nënshtrohet vështirimit hetues të një mekanizmi, përbërja, rregullat dhe procedurat e të cilit mbesin të paqarta.

Në letër, edhe EULEX-i është i pajisur me kompetenca të gjëra – dhe të pakontrolluara – ekzekutive. Neni 3 (b) i Veprimit të Përbashkët në mënyrë specifike thotë që personeli i EULEX-it gëzon autoritetin ‘sipas nevojës, në konsultim me autoritetet relevante ndërkombëtare civile në Kosovë’ të ‘*kthej prapa apo anuloj* vendimet operationale të autoriteteve kompetente kosovare.’³⁶ Personeli i EULEX-it do të gëzoj imunitete të ngjashme me personelin e ZCN-së dhe UNMIK-ut.

Llogaridhënja poashtu, në rend të parë është karrshi një trupi ndërkombëtar, në këtë rast te Këshilli i Unionit Evropian e jo te autoritetet Kosovare. Poashtu nuk ekziston zinxhiri i qartë dhe i unifikuar komandues në mes të Përfaqësuesit Civil Ndërkombëtar dhe shefit të misionit të EULEX-it. Në esencë, në Kosovë do të jenë dy qendra të fuqisë, dhe të dyja do të pohojnë që e udhëheqin Kosovën drejt të ardhmes evropiane, të dyja do të kenë kompetenca të gjëra ekzekutive dhe të dyja do ti raportojnë dhe do të marrin udhëzime nga një trup i jashtëm i cili përfaqëson një grup të ndryshëm të shteteve. Peter Feith si PCN do t’i raportoj Grupit Drejtues Ndërkombëtar, derisa Yves de Kermabon, si shef i EULEX-it, do t’i marr udhëzimet e tij nga PSC-ja e cila vepron nën përgjegjësinë e Këshillit të Bashkimit Evropian. Dispozita e vetme për ‘bashkëpunim’ institucional parasheh që:

‘Komandanti i Operacioneve Civile dhe Përfaqësuesi Special i Bashkimit Evropian (PSBE) do të konsultohen njeri me tjetrin sipas nevojës.’³⁷

³³ Konventa e Vjenës për Marrëdhënie Diplomatike, 1961. Neni 41, f.13

³⁴ Propozimi Gjithëpërfshirës për Marrëveshjen mbi Statusin e Kosovës, aneks në ‘Raport i të Dërguarit të Posaçëm të Sekretarit të Përgjithshëm për Statusin e Ardhshëm të Kosovës,’ Këshilli i Sigurimit i OKB-së, Aneks IX, Neni 4.1 dhe Neni 4.2.

³⁵ *Ibid.*, Aneks IX, Neni 4.2.

³⁶ Veprimi i Përbashkët i Këshillit, 2008/124/CFSP, 4 shkurt 2008; Gazeta zyrtare e Bashkimit Evropian Official; Neni 3, (b)

³⁷ *Ibid.*, Neni 7.6

Në pajtim me planin gjashtëpikësh të Ban Ki-moon, shefi i EULEX-it poashtu duhet t'i raportoj Selisë së OKB-së në Nju Jork. Fare nuk përmenden konsultimet me zyrtarët e zgjedhur kosovarë. Autoritetet kosovare nuk parashihet të jenë as pjesë e diskutimeve për zgjatjen apo rishikimin e mandatit të EULEX-it. Kjo varet plotësisht nga Këshilli dhe vendet anëtare, apo me fjalë tjera nga Veprimi i Përbashkët:

‘Këshilli do të vlerësoj, jo më vonë se gjashtë muaj pas fillimit të fazës operacionale, nëse mandati i EULEX-it duhet të zgjatet.’³⁸

Është e qartë që misioni i ri ndërkombëtar në Kosovë nuk është një ‘prezencë e lehtë’ për të cilën flet retorika zyrtare e Brukselit. Pse duhet të na brengos kjo?

STRATEGJIA DALËSE

Ahtisaari kishte paraparë që ‘roli mbikëqyrës i bashkësisë ndërkombëtare do të përfundonte vetëm kur Kosova të zbatoj masat e parapara në Marrëveshjen e propozuar.’³⁹ Ahtisaari poashtu shtonte që ‘përkundër këtij angazhimi të fuqishëm ndërkombëtar, autoritetet e Kosovës në instancë të fundit janë përgjegjëse dhe duhet të japin llogari për zbatimin e Marrëveshjes së propozuar.’⁴⁰

Qeveria e Kosovës është përkushtuar fuqishëm për zbatimin e Marrëveshjes së Ahtisaarit për Statusin. Paragrafi 3 i Deklaratës së Pavarësisë thotë:

‘Ne i pranojmë plotësisht obligimet për Kosovën nga Plani i Ahtisaarit, dhe e mirëpresim kornizën e propozuar për ta udhëhequr Kosovën në vitet e ardhshme. Ne do t'i zbatojmë këto obligime në tërësi nëpërmjet përshtatjes prioritare të legjislacionit të përfshirë në Aneksin XII, posaçërisht ato që mbrojnë dhe promovojnë të drejtat e komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre.’⁴¹

E njëjta vlen edhe për Kushtetutën e re të Kosovës, ku një kapitull i tërë i është kushtuar pakos së Ahtisaarit. Kapitulli XIII (Dispozitat Përfundimtare) thotë që:

‘Të gjitha autoritetet e Republikës së Kosovës do t'i përmbahen të gjitha obligimeve të Republikës së Kosovës sipas Propozimit Gjithëpërfshirës për Marrëveshjen mbi Statusin e Kosovës të datës 26 mars 2007. Ato do t'i ndërmarrin të gjitha veprimet e nevojshme për zbatimin e këtyre obligimeve.’⁴²

³⁸ *Ibid.*, Neni 19

³⁹ Letra e datës 26 mars 2007 e Sekretarit të Përgjithshëm për Presidentin e Këshillit të Sigurimit, f.4

⁴⁰ Letra e datës 26 mars 2007 e Sekretarit të Përgjithshëm për Presidentin e Këshillit të Sigurimit, f.4

⁴¹ Deklarata e Pavarësisë së Kosovës – 17 shkurt 2008

⁴² Kushtetuta e Republikës së Kosovës – Kapitulli XIII, Neni 143.1

Për më tepër, ‘dispozitat e Propozimit Gjithpërfshirës për Marrëveshjen mbi Statusin e Kosovës të datës 26 mars 2007 do të qëndrojnë mbi të gjitha dispozitat e tjera ligjore në Kosovë.’⁴³

Në arenën ndërkombëtare, Kosova poashtu është zotuar t’i zbatoj me përpikmëri dispozitat e marrëveshjes për statusin. Në letrën dërguar 192 Ministrive të Jashtme të vendeve anëtare të OKB-së, Qeveria e Kosovës theksoi:

‘Me deklaratën [e Pavarësisë], ne në mënyrë të pakthyeshme e kemi përkushtuar Kosovën për zbatimin e plotë të të gjitha obligimeve që burojnë nga Propozimi Gjithpërfshirës i të Dërguarit të Posaçëm të OKB-së, përfshirë poashtu edhe të ardhmen multietnike dhe demokratike të Kosovës, mbrojtjen e të drejtave të të gjitha komuniteteve dhe të gjitha dispozitat që kanë të bëjnë me mbikëqyrjen ndërkombëtare të Kosovës.’⁴⁴

Megjithatë, ka kufizime se deri në çfarë mase mundet Qeveria në Prishtinë në mënyrë unilaterale të zbatoj kushtet e marrëveshjes për statusin. Plani i Ahtisaarit qëllimisht ishte hartuar në atë mënyrë që t’i detyroj të gjitha palët të bashkëpunojnë. Në letrën e tij dërguar Këshillit të Sigurimit të OKB-së, Ahtisaari edhe një herë konfirmoi që Kosova mund të ketë sukses:

‘Në këtë përpjekje vetëm nëse ka përkushtimin dhe pjesëmarrjen aktive të të gjitha komuniteteve, përfshirë në veçanti serbët e Kosovës.’⁴⁵

Derisa Marrëveshja e Ahtisaarit i jep kompetenca të gjera ZCN-së dhe EULEX-it për të detyruar bashkëpunimin në Prishtinë, ajo megjithatë nuk përmban dispozita që e obligojnë Serbinë apo serbët e Kosovës që ta përkrahin procesin e zbatimit. Dispozitat kyçe të Marrëveshjes, që nga decentralizimi e deri te mbrojtja e trashëgimisë kulturore, nuk mund të zbatohen të paktën pa shenjë përkrahjeje nga Beogradi.

Sa i përket serbëve të Kosovës, përvoja e viteve të fundit na ka mësuar që ata janë shumë të mvarur nga politika e Beogradit. Dhe nuk ka dëshmi që të besojmë se kjo sjellje do të ndryshoj në të ardhmen e afërt. Meqë nuk pritet ndonjë ndryshim në politikën e Beogradit, ne nuk presim shumë sa i përket bashkëpunimit me përfaqësuesit politik të komunitetit serb në Kosovë. Përveç nëse BE-ja guxon ta kushtëzoj procesin e anëtarësimit të Serbisë në BE me të paktën përkrahjen e heshtur të Beogradit për Marrëveshjen e Ahtisaarit dhe për zbarkimin e EULEX-it në mbarë Kosovën, Kosova përsëri do të mbetet peng i vendimeve politike në Beograd.

⁴³ Kushtetuta e Republikës së Kosovës – Kapitulli XIII, Neni 143.2

⁴⁴ Letra e Qeverisë së Kosovës dërguar 192 vendeve anëtare të OKB-së më 17 shkurt 2008 duke kërkuar njohjen e pavarësisë.

⁴⁵ Propozimi Gjithpërfshirës për Marrëveshjen mbi Statusin e Kosovës – Këshilli i Sigurimit i OKB-së, 26 mars 2007

PERSPEKTIVA EVROPIANE

Në verë të vitit 2005, paraardhësi i Ban Ki-moon-it i kishte dhënë diplomatit norvegjez Kai Eide detyrën e rekomandimit të procesit për zgjidhjen e statusit përfundimtar të Kosovës. Eide kërkoi që ‘kur të filloj procesi, ai nuk mund të bllokohet dhe duhet të përfundohet’. Në raportin e tij, Eide konkludoi:

“Bashkësia ndërkombëtare duhet të bëjë çdo gjë të siguroj që, pa marrë parasysh statusin e ardhshëm, ai nuk do të bëhet status ‘i dështuar.’ Kosova nuk mund të mbetet përgjithmonë nën administrimin ndërkombëtar.”⁴⁶

Eide poashtu u bëri thirrje të gjithë akterëve që ta ndihmojnë Kosovën ta përmbush të ardhmen e saj evropiane.

‘Kosova ndodhet në Evropë, ku ekzistojnë organizata të fuqishme rajonale. Në të ardhmen, ato – dhe në veçanti Bashkimi Evropian (BE) – do ta luajnë rolin kyç në Kosovë. Ato do të gëzojnë kompetencat e nevojshme dhe do të jenë në gjendje të ofrojnë prospekte përbrenda kornizës së integriteteve evropiane.’

Në Principet Udhëzuese, Grupi i Kontaktit poashtu u bëri thirrje të gjitha palëve që të sigurojnë se marrëveshja përfundimtare në Kosovë do t’i ‘kontribuoj përmbushjes së perspektivës evropiane të Kosovës.’⁴⁷ Por pikë së pari e ardhmja Evropiane e Kosovës është ajo e cila sot është e varur në balance. Derisa pesë vende anëtare të BE-së nuk e njohin Kosovën, nuk ka shumë gjasa që Kosova të lidh marrëdhënie kontraktuale me Bashkimin Evropian. Nënshkrimi i Marrëveshjes së Stabilizimit dhe Asociimit, që është hapi i parë në rrugën e gjatë drejt anëtarësimit në BE, është i pamundur nëse me këtë nuk pajtohen të gjitha 27 vendet anëtare. Ka pak gjasa që të sigurohet një pajtim i tillë nga vendet anëtare që as nuk i njohin autoritetet Kosovare si legjitime.

Në muajt e fundit është bërë e qartë që Evropa heziton ta kushtëzoj të ardhmen evropiane të Serbisë me Kosovën. IKS-i mendon se ky është gabim; do të ishte më mirë për Serbinë, Kosovën dhe tërë rajonin nëse BE-ja do të thoshte në mënyrë të qartë që perspektiva e integritetit të Serbisë në BE varet nga përkrahja e Serbisë për zbatimin e suksesshëm të marrëveshjes për statusin përfundimtar të Kosovës. Ne rekomandojmë që progresi në procesin e hyrjes së Serbisë në BE të kushtëzohet me ndërtimin e marrëdhënieve të fqinjësisë së mirë me Kosovën, që është kërkesë e zakonshme për të gjitha vendet që aspirojnë të bëhen pjesë e BE-së.

⁴⁶ Letra e datës 7 tetor 2005 e Sekretarit të Përgjithshëm për Presidentin e Këshillit të Sigurimit (S/2005/635); 7 tetor 2005

⁴⁷ Principet Udhëzuese të Grupit të Kontaktit për marrëveshjen mbi statusin e Kosovës; 15 nëntor 2005.

Obstrukcioni i qartë nga Beogradi, qoftë në mënyrë të drejtpërdrejt apo të tërthortë duke bërë presion mbi komunitetin serb të Kosovës, nuk duhet të shpërblehet me integrim të përsheptuar. Procesi i anëtarësimit në BE në bazë të meritave i cili ka pasur aq shumë sukses në kushtëzimin e reformave në vendet siç janë Estonia dhe Bullgaria tash po rrezikon të minohet nga koncesionet e pakushtëzuara për Serbinë. Procesi i anëtarësimit në BE është kushti kryesor i BE-së që të kërkojë reforma në vendet e rajonit. Prandaj, për t'i shfrytëzuar në tërësi kushtëzimet politike, komponentët e ndryshëm që e përbëjnë prezencën e BE-së në Serbi dhe në Kosovë duhet të flasin me një zë të unifikuar. Kjo nuk vlen vetëm për Kosovën; këtu është në pyetje edhe vet kredibiliteti i BE-së.

Por në të njëjtën kohë edhe Prishtina ka shumë punë për të bërë. Pas shpalljes së pavarësisë, tash është momenti i duhur që qeveria e Prishtinës t'i përcaktoj vetes qëllime të reja. Bullgarisë i janë dashur 14 vite nga nënshkrimi i Marrëveshjes së Stabilizimit dhe Asociimit që të bëhet anëtare e plotë e BE-së. Kosovës i kanë mbetur vetëm edhe 12 vite nëse dëshiron t'i bashkangjitet Bashkimit Evropian në vitin 2020; Prishtina duhet ta përshejtoj punën e saj. Për ta kaluar Bullgarinë dhe për ta arritur hapin me fqinjët e saj, Kosova duhet ta nënshkruaj Marrëveshjen e Stabilizimit dhe Asociimit deri në vitin 2010, ta dorëzojë kërkesën për status të vendit kandidat deri në vitin 2012 dhe të hyjë në negociatat për anëtarësim deri në vitin 2015. Kjo është agjendë ambicioze; donatorët dhe vendet anëtare të BE-së sigurisht do ta diskurajojnë Kosovën nga kjo agjendë. Mirëpo tash është radha e Qeverisë së Kosovës që të jetë vizionare dhe këmbëngulëse.

Për ta arritur këtë qëllim, politikanët e Kosovës duhet të zhvillojnë një vizion të qartë dhe një plan të besueshëm të veprimit për t'i zbatuar dispozitat e marrëveshjes për statusin përfundimtar që janë në kompetencat e qeverisë. Përfundimi i shpejtë i kushteve të marrëveshjes për statusin është parakusht që Kosova të niset vendosmërisht në rrugën drejt integritetit në BE. Marrëveshja e Ahtisaarit është vetëm një hap drejt synimit më të rëndësishëm, më shpërblyes dhe më sfidues. Një lidhësi i cili në mënyrë proaktive i zbaton edhe pjesët më të vështira të Marrëveshjes dhe e kufizon prezencën e fuqisë mbikëqyrëse ndërkombëtare në minimumin e saj absolut (2 vite + periudha e rishikimit + përmbyllja) është shansi i vetëm i Kosovës që t'i bashkangjitet BE-së në 20 vitet e ardhshme.

Për t'iu kundërvënë arsyetimit të vazhdueshëm të prezencës së gjerë të BE-së me fuqi të mëdha ekzekutive – BE-ja duhet t'i përkushtohet definimit të qartë të kushteve të procesit të rishikimit me synim që ta mbaroj me kohë mbikëqyrjen ndërkombëtare. Propozimi i Ahtisaarit është qëllimisht i mjegullt sa i përket kufizimeve të mbikëqyrjes ndërkombëtare dhe procesit të rishikimit. Në tekstin e Marrëveshjes flitet për rishikimin e kompetencave të PCN-së pas dy viteve '[...] me synim që të zvogëlohet në mënyrë graduale fushëveprimi i kompetencave të PCN-së dhe shpeshësia e ndërhyrjes.'⁴⁸

⁴⁸ 'Propozimi Gjithëpërfshirës për Marrëveshjen mbi Statusin e Kosovës,' aneks në 'Raport i të Dërguarit të Posaçëm të Sekretarit të Përgjithshëm për Statusin e Ardhshëm të Kosovës,' Këshilli i Sigurimit i OKB-së, S/2007/168/Add.1, Aneksi IX, Neni 5.1.c.

Vendimi përfundimtar për kohën dhe mënyrën e përmbylljes së mandatit të PCN-së është në duart e Grupit Drejtues Ndërkombëtar.⁴⁹ Kjo megjithatë nuk është në përputhje me principet ndërkombëtare të transparencës dhe llogaridhënies demokratike. Kjo ngërthen në vete edhe rrezikun e ‘vazhdimit të gjatë të misionit,’ siç kemi parë me rastin e UNMIK-ut.

UNMIK-u ka kohë të gjatë që nuk është i mirëseardhur në Kosovë, por poashtu ka dështuar të hartoj një strategji elegante të largimit. Për t’iu shmangur përsëritjes së gabimit të njejtë edhe nga ZCN-ja dhe EULEX-i, procesi i rishikimit duhet të zhvillohet në mënyrë transparente, me konsultime të ngushta me qeverinë e Kosovës dhe duhet të ketë validitet të jashtëm. Qeveria e Kosovës duhet të ketë mundësi të kërkoj një mendim të dytë nga një mekanizm i pavarur – jashtë strukturave ekzistuese të ZCN/PSBE.

Duke marrë parasysh përkushtimin e madh të qeverisë së Kosovës për zbatimin e kushteve të Marrëveshjes së Ahtisaarit, IKS-i beson që edhe Kuvendi i Kosovës duhet të ketë rol të qartë në procesin e rishikimit. Kjo do të sigurojë të paktën një masë të caktuar të llogaridhënies demokratike. IKS-i rekomandon që dispozitat e Marrëveshjes së Ahtisaarit që nuk janë zbatuar në masë të kënaqshme deri në kohën e procesit të rishikimit duhet të përfshihen në procesin e anëtarësimit në BE. Kështu, Bashkimi Evropian siguron mënyrë shumë më efektive dhe transparente për ushtrimin e ndikimit politik mbi Kosovën.

Për më tepër, bashkësia ndërkombëtare duhet të përmbahet nga progresi në zbatimin e marrëveshjes së statusit në varësi nga progresi në fushat tjera siç është ‘çrrënjësja e korrupsionit’ apo ‘lufta kundër krimit të organizuar’ në Kosovë. Përzjerja e këtillë e qëllimeve dhe synimeve vetëm do ta zgjas prezencën e shtrenjtë ndërkombëtare në Kosovë për një afat të pacaktuar, dhe do t’i zhvishte politikanët vendorë nga iniciativat për të marrë përgjegjësinë për këto probleme.

Barra financiare e komunitetit evropian për misionin e shtrenjtë policor, ushtarak dhe politik duhet të shoqërohet edhe me fonde që e ndihmojnë ekonominë kosovare të nisët në rrugën e zhvillimit të qëndrueshëm. Përqendrimi i ngushtë në zbatimin e dispozitave të Marrëveshjes së Ahtisaarit dhe alokimet e mëdha të fondeve për kostot e ndërlidhura me statusin mund të kenë efekt të padëshirueshëm. Donatorët dhe qeveritë nuk duhet ta financojnë prezencën e stërzgatur ndërkombëtare në dëm të investimeve në çështje të rëndësishme strategjike siç janë zhvillimi ekonomik dhe zhvillimi i kapitalit njerëzor. Përfundimisht, çelësi i stabilitetit rajonal nuk qëndron në numrin e policëve evropian që janë zbarkuar në Kosovë, por në numrin e vendeve të punës që do të krijohen gjatë viteve të ardhshme.

⁴⁹ *Ibid.*, Aneks IX, Neni 5.2.

Përderisa ekziston nevoja për prezencën ndërkombëtare e cila i garanton të drejtat e pakicave, BE-ja nuk duhet të synoj të merret me të gjitha problemet e qeverisjes në Kosovë. Në fund të fundit, BE-ja nuk kishte dërguar një Përfaqësues Ekzekutiv Ndërkombëtar dhe një mision policor me 2,000 pjesëtarë në Serbi apo Shqipëri për t'i zgjidhur mangësitë e vazhdueshme demokratike të këtyre dy vendeve dhe për problemet e tyre me korrupsion dhe krim të organizuar. Në vend të kësaj, BE-ja është angazhuar me këto vende nëpërmjet mekanizmave konvencional të diplomacisë ndërkombëtare, duke kushtëzuar në mënyrë të veçantë prospektin e integrimit të tyre të ardhshëm në BE.

Nuk ka asnjë arsye pse qasja në rastin e Kosovës duhet të jetë e ndryshme. Populli i Kosovës duhet të jenë ata që do të zgjedhin politikanët që kanë vizionin dhe energjinë e duhur për ta çuar përpara politikën Kosovare të integrimit në BE. Por i takon BE-së që t'ia jap Kosovës shansin e vërtetë.

Për ne

Iniciativa Kosovare për Stabilitet (IKS) është think-tank i pavarur dhe joprofitabil i cili përqëndrohet në kërkime empirike dhe analiza të zhvillimeve socio-ekonomike në Kosovë. E themeluar në vitin 2004, IKS ofron hulumtime inovative dhe relevante për politikën me synim që të nxis debate për çështjet e rëndësishme për të ardhmen e Kosovës.

Ne besojmë që debatet publike të bazuara në dëshmi janë thelbi i vendimmarrjes demokratike.

Që nga vera e vitit 2004, IKS ka zgjeruar stafin dhe sot përfshin katër analistë dhe hulumtues me orar të plotë, dhe rrjet në rritje e sipër të hulumtuesve dhe ndihmësve. IKS përkrahet në punën e saj nga Bordi Këshilldhënës i përbërë nga analistë dhe praktikues kosovarë dhe ndërkombëtarë.

Që nga zanafilla e saj, IKS është përqendruar në çështjet e qeverisjes, zhvillimit ekonomik, planifikimit urbanistik, korrupsionit në rindërtimin post-konfliktual, arsimit dhe problemit të imazhit të Kosovës në vendet e jashtme. IKS është poashtu pjesë e rrjetit të think-tanks në mbarë Evropën Juglindore të inspiruar nga ESI.

Të gjitha raportet tona mund të gjeni në uebfaqen tonë.

Iniciativa Kosovare për Stabilitet — IKS

Telefoni: + 381 38 222 321

E-mail: info@iksweb.org

www.iksweb.org

Adresa:

Rr. Garibaldi H11/6, Prishtinë, Kosovë